

AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUARA
“ENTA GROUP” SH.P.K

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar me emrin **“ENTA GROUP”** Sh.p.k, është themeluar në bazë të aktit të themelimit sipas Ligjit Nr 9901, datë 14.04.2008 “për Tregtarët dhe shoqëritë tregtare “ i ndryshuar me Ligjin Nr 10475, datë 27.10.2011 dhe me Ligjin 129/2014 si dhe në Ligjin 9723. Datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit “ i ndryshuar me Ligjin Nr 9916, datë 12.05.2008, me Ligjin Nr. 92/2012, datë 27.09.2012, dhe me Ligjin Nr.8/2015 datë 19.02.2015 si dhe në Përputhje me legjislacionin në fuqi;

Neni 1

Themeluesit e Shoqërisë

Eneida Fatkoja, e bija e Ilirjan, lindur në Elbasan, më 07.12.1987 shtetase shqipëtare, banuese në Tiranë, madhore me zotësi të plota juridike dhe për të vepruar, mbajtëse e letërnjoftimit me nr.I76207044N

Neni 2

Emri i Shoqërisë

Është themeluar shoqëria **“ENTA GROUP” Sh.p.k, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar** të cilën do të quhet **“ENTA GROUP” Sh.p.k.**

Neni 3

Selia

Selia kryesore e shoqërisë do të jetë në Tiranë me adresë “Rruga e Dafinave”, Tirane.

Neni 4

Objekti

Shoqëria “ENTA GROUP” sh.p.k, do të ketë si objekt të veprimtarisë:

1. Bar Restorant, Shërbim, Katering;
2. Tregtim me shumicë dhe pakicë të produkteve ushqimore, lende e parë etj;
3. Prodhim tregtim dhe import/eksport, të laboratorëve të industrisë së ushqimit dhe aksesorëve përkatës, produkte të ndryshme ushqimore, pije alkolike etj;
4. Ndërtime dhe rikonstruksione të objekteve civile, Industriale, tregtare, turistike, shëndetësore kulturore, sportive, vepra kullimi për vaditje, infrastrukturë shërbime komunale e urbane, ndërtime rrugore e hekurudhore, projektme të



- objekteve të sipër tregtuara, blerje dhe shitje trojesh, ndërtesa dhe pasuri të paluajtshme, Prodhim transmetim shpërndarjen dhe shitjen e energjisë elektrike.
5. Aktiviteti në fushën e ndërtimit, projektimin e objekteve, punime muratore, punime tarrace, paisje me materiale të ndryshme ndërtimi, paisje impiante hidraulike, impiante elektrike, punime shtresash dyshemesh, riparime dhe rikonstruksionin;
 6. Vlersimin e pasurive të paluajtshme, hartimi i raporteve të vlersimit të ndikimit në mjedis , për të kryer auditim mjedisor, për hartimin e ekspertizave për problem mjedisor.
 7. Shërbim Konsulence, Prokurime, shërbime në planifikim urban, transporti, topografike, gjeologjike, hidrogjeologjike, infranstrukturë ambientale, projektim objektsh civile, arsimore, sportive industriale, ushqimore, bujqësore, materiale ndërtimi, elektrike, elektronike, sanitare, Grumbulim transportim i ujrave të ndotura.
 8. Shoqëria mund të kryejë cdo veprimtari të nevojshme e të dobishme, të lejuar nga ligji për realizimin e objektit të saj.

Neni 5

Kohëzgjatja

Shoqëria **"ENTA GROUP"** sh.p.k, kryen veprimtarinë e saj për një periudhë kohe të pacaktuar derisa të vendoset ndryshe nga asambleja e shoqërisë.

Neni 6

Drejtimi

Organet drejtuese të shoqërisë janë;

1. Asambleja e përgjithshme që përbëhet nga themeluesit e shoqërisë;
2. Administratori

Shoqëria do të administrohet nga një ose më shumë administratorë që emërohen për një periudhë prej 5(pesë) vjecare. Administrator i shoqërisë do të jetë:

Administratorja e shoqërisë për periudhën 5-Vjecare emërohet ENEIDA FATKOJA Eneida Fatkoja, e bija e Ilirjan, lindur në Elbasan, më 07.12.1987 shtetase shqipëtare, banuese në Tiranë, madhore me zotësi të plota juridike dhe për të vepruar, mbajtëse e letërnjoftimit me nr.**I76207044N**.

Neni 7

Kapitali

Kapitali fillestar i shoqërisë do të jete 100 lekë (njëqind lekë)



Ortakja e veteme themeluese Znj. Eneida Fatkoja do të zotërojë Kuotën me vlerë 100 % të kapitalit themeltar të shoqërisë;

Neni 8

Viti ushtrimor

Viti ushtrimor fillon me ditën e regjistrimit të shoqërisë në regjistrin tregtar të shoqërive dhe mbyllet me 31 Dhjetor 2024

Neni 9

Të tjera

Shoqëria krijohet dhe do ta ushtrojë aktivitetin e saj në përputhje me ligjet shqiptare në fuqi. Ligji 9901, datë 14.04.2008 I shoqëruar me shtesa dhe ndryshime nr. 129/2014, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" dhe ligje të tjera që do të jenë në fuqi gjatë periudhës së ushtrimit të aktivitetit të shoqërisë.

Ky akt themelimi është i hartuar në tre ekzemplarë, pasi u lexua nga themeluesi i shoqërisë dhe u gjet konform vullnetit të tyre të plotë, firmoset rregullisht me datë 08/02/2024.

Themelues

Eneida Fatkoja



